



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.997/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Petrol Compoany” shpk , me NUI ..., me seli ne Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës” sha, me seli ne rr. “Dardania” pn, Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.229/22 dt.31.03.2023, me datën 08.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Telekomi i Kosovës” sha, me seli ne rr. “Dardania” pn, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.229/22 dt.31.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës– Dhomat e Shkallës se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.229/22 dt.31.03.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit pjesërisht ka aprovuar prapësimin e debitorit Telekomi i Kosovës sh.a dhe ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor te Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi P.nr.2825/19 dt.03.12.2019, për pjesën e detyrimit ne shumen prej 40,535.84 euro sipas faturës nr.176/19 dt.31.01.2019. Ne pjesën në II te dispozitivit te këtij aktvendimi ka refuzuar pjesërisht si te pabazuar prapësimin e debitorit Telekomi i Kosovës sh.a dhe mbetet ne fuqi pjesa tjetër e urdhrin përmbarimor P.nr.2825/19 dt.03.12.2019, i Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi sa i përket shumës prej 88,379.95 euro se bashku me kamatën ligjore sipas normës se interesit vjetor 8%. Ndërsa ne pjesën e III te dispozitivit te këtij urdhri ka përfunduar procedurën përmbarimore te kreditorit Petrol Company shpk ndaj debitorit Telekomi i Kosovës sh.a sipas urdhri përmbarimor P.nr.2825/19 dt.03.12.2019 për shumen prej 40,535.84 euro.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, aplikimit te gabuar te se drejtës procedurale dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe lënda te kthehet ne rigjykim .

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Petrol Company” shpk , me NUI 810527195, me seli ne Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, me datën 02.12.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës” sha, me seli ne rr. “Dardania” pn, Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.176/19 dt.31.01.2019, 2154/19 dt.06.08.2019, 2519/19 dt.09.09.2019, 3018/19 dt.09.10.2019, 3043/19. Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, Prishtinë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.2825/19 dt.03.12.2019 ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat, t’i paguaj shumën prej 128,915.79 euro, me kamatë vjetore 8% nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 12.12.2019, përmes se cilit pretendon se dokumentet ne baze te cilit është iniciuar proceduara përmbartimore nuk e kanë cilësinë e dokumentit te besueshëm konform nenit 29 par.3 dhe nenit 37 te LPP, po ashtu theksoi se ne procedurën përmbartimore është me rendësi vërtetimi i saktë i faktit se kreditori a i ka përmbushur detyrimet e tija kontraktuese, shton se urdhri përmbartimor është i pabazuar, andaj edhe propozon qe gjykata ta pranoj prapësimin e debitorit, ta abrojoj urdhrin përmbartimor dhe ta obligoj kreditorin ti barte shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 13.12.2019, me arsyetimin se asnjë nga pretendimet e debitorit nuk paraqet baze për prapësim sepse se bashku me propozimin për përmbartim i kanë dorëzuar tek përmbartuesi privat edhe faturat ne origjinal dhe se përmes emailave me debitorin dt.27.11.2019, 29.11.2019, e kanë njoftuar debitorin se nuk e ka kryer detyrimin ndaj kreditorit. Kreditori deklaroi se pas inicimit te procedurës përmbartimore debitori ka kryer një pjese te detyrimit ndaj kreditorit dhe atë shumën ne vlerë prej 40,535.84 euro ashtu qe obligimi i debitorit ndaj kreditorit me tej mbetet ne shumën prej 88,379.95 euro duke ofruar për këtë edhe dëshmi ne lende pagesën e datës 09.12.2019. Propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta provoj ne tërësi urdhrin përmbartimor dhe i njëjti te detyrohet ne përmbushjen e obligimeve.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.229/22 dt.31.03.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lenë ne fuqi pjesërisht urdhrin përmbartimor ndërsa ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimore, duke vendosur si në dispozitiv të

aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka anuluar pjesërisht urdhrin përbarimor bazuar ne pohimin e kreditorit te dhënë ne përgjigjen ne prapësim si dhe ne bazë te fletëpagesës nr.176/19dt.31.01.2019 nga ku vërtetohet se debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin për faturën nr.176/19 dt.31.01.2019 ku nga borxhi total në shumen prej 59,535.84 euro debitori ka paguar shumen prej 40,535.84 euro. Sa i përket kamatës ne 8% e kërkuar nga kreditori gjykata bazuar ne nenin 382 te LMD ka lënë ne fuqi urdhrin përbarimor duke konsideruar se kreditorit i takon drejta ne kamatëvonesë lidhur me shumen prej 88,379.95 euro qe nga momenti kur faturat janë bere te arritshme për pagesë e deri ne pagesën definitive, andaj nga këto gjykata e shkallës se pare ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Nisur nga ko gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës gjegjësisht pohimit te kreditori ne përgjigje ne prapësim te datës 13.12.2019 si edhe nga dëshmia e ofruar qe gjendet ne shkresat e lëndës dt. 09.12.2019 rezulton se debitori ka bërë pjesërisht shlyerjen detyrimit ndaj kreditorit, sepse i njëjti ka paguar shumen e detyrimit prej 40,535.81.

Po ashtu gjykata e shkalles se parë ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore me rastin e vendosjes sepse faturat 2154/19 dt.06.08.2019, 2519/19 dt.09.09.2019, 3018/19 dt.09.10.2019, 3043/19, mbi bazën e te cilave është iniciuar përbarimi, plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente te besueshme nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, dhe par.3 te këtij neni i cili thotë *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar’* dhe se e njëjtat si e tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë ne pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimi ti bashkëngjitet dokumentit tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Neni 382 par.1 I LMD parasheh qe *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, andaj edhe përfundimi juridik i gjykatës e shkalles se parë edhe ne këtë aspekt është i drejte dhe ligjor.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, pranon ne tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë analizon edhe pretendimet e palës debitore se gjykata e shkallës se parë ka bere shkelje te dispozitave ligjore dhe vërtetim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike por qe vlerëson se

pretendimet e tilla nuk i ka bazuar dhe te argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, prandaj edhe i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin atakuar e vërtetoj. Sa i përket pretendimeve lidhur me kompetencën e paraparë me kontratë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur si organ përmbartues i shkallës së dytë e ka trajtuar çështjen e vendosur nga përmbartuesi privat, pasi që pavarësisht klauzolës së kontraktuar për mosmarrëveshjet që lindin nga kontrata, realizimi i detyrimit monetar bie në kompetencë të organit përmbartues në kuadër të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Pretendimi tjetër ankimor për kamatën po ashtu është i pasaktë, pasi që kamata në detyrimet monetare lind sipas fuqisë ligjore, e paraparë me dispozitat e LMD-së dhe gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë me rastin e trajtimit të prapësimeve lidhur me propozimin për përmbartim. Po ashtu, pretendimi i debitorit për pagesën e plotë të borxhit, me pretekstin e bashkëngjijtes së kartelës së klientit, nuk mund të pranohet si i qëndrueshëm për faktin se kartela e klientit nuk paraqet provë të besueshme dhe kredibile në këtë procedurë. Barra e provës për vërtetimin e pohimeve të palëve bie mbi vet palët – në rastin konkret mbi debitorin. Kjo gjykatë vlerëson se debitori nuk ka marr mundin për të dëshmuar përmes pagesave bankare se vërtetë borxhi është paguar, por është mjaftuar me një dokument intern që procedohet nga vet debitori, e që nuk ka ndonjë peshë të të provuarit të fakteve. Rrjedhimisht, qasja e tillë e debitorit nuk mund të mjaftohet për të pranuar faktet e pretenduara si të bazuara, ngase asnjë nga provat nuk arrin besueshmëri të mjaftueshme për ta pranuar ankesën si të bazuar.

Gjykata sqaron se në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin. Rrjedhimisht, gjykata në procedurën e përmbartimit nuk ka tagër dhe as autorizime ligjore për të vlerësuar faktet që rrjedhin nga kontesti midis palëve dhe nuk lëshohet në verifikimin e përmbushjes apo jo të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, mirëpo kufizohet vetëm në ekzaminimin e kushteve ligjore të titullit ekzekutiv.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës se Dytë  
K.DH.SH.II nr. 997/23, me datë 08.12.2023

Gjyqtari,  
Dren Rogova